

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Osmani: UÇK mbetet pjesa më krenare e historisë moderne të popullit tonë, dje, sot e përjetësisht
ADRESA	https://www.gazetatema.net/rajoni/osmani-uk-mbetet-pjesa-me-krenare-e-historise-moderne-te-popullit-tone-dj-i586469
BURIMI	gazetatema.net
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	16 shtator 2026, 11:58:36 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	16 shtator 2026, 11:50:07 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	846466ebfbb31d202d2026d20621b27501023e2dc30fe921f324a14908ba4c62
TEKSTI	ca416ef5d7bc6be4b9bcc0757536c7629477ce8a4c520923341742dea4e5f2c1
PAMJA	c1a6ad698e7b25d88f906e6b2e183ce8321844c8673adcda4f91f28dedf7e0d4

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	ec0864e53e4445c6d3cfcfb5ffb3f24dcd8168c332cd8d833d261b45677d663c
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	aa4643f280403755043cdd17fa8b750c8d4cc9789c755656633151c3e6ad021e
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/ec0864e53e4445c6d3cfcfb5ffb3f24dcd8168c332cd8d833d261b45677d663c>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px



- [Politika](#)
- [Sociale](#)
- [Kronika](#)
- [Ekonomia](#)
- [Editorial](#)
- [Antena](#)
- [Blog](#)
- [Rajoni](#)
- [Bota](#)
- [Kulturë](#)
- [Sport](#)
- [Lifestyle](#)

English

Built and Monetized by

[Kontakt](#)

English

ie Vendimi per ish-kreret e UÇK-se, Igi Hasani: Thellesisht zhgenjyes, beteja vazhdon ne apelOsmani: UÇK mbetet pjesa me krenare e historise moderne te popullit tone, dje fundit

Osmani: UÇK mbetet pjesa më krenare e historisë moderne të popullit tonë, dje, sot e përjetësisht



16 Shtator 2026, 13:50Rajoni TEMA



Ish-presidentja e Kosovës, Vjosa Osmani ka reaguar lidhur me dënimin e ish-krerëve të UÇK-së nga Gjykata Speciale në Hagë. Osmani shkruan se UÇK-ja mbetet pjesa më krenare e historisë moderne të popullit të Kosovës. Ajo shkruan se populli i Kosovës u ngrit kundër krimeve dhe në mbrojtje të pragut të shtëpisë. Sipas saj shteti i pavarur e sovran i Kosovës është amaneti i përbashkët.

“UÇK-ja mbetet pjesa më krenare e historisë moderne të popullit tonë: dje, sot e përjetësisht! Mbi 13 mijë njerëz janë vrarë nga Serbia gjenocidale gjatë luftës në Kosovë. Prej tyre, rreth 10 mijë ishin civilë të masakruar, ndërsa më shumë se 1500 ende mbesin të zhdukur me dhunë dhe në varreza masive. Dhunimet seksuale, torturat çnjerëzore, vrasjet e fëmijëve dhe krimet e tjera të llahtarshme të Serbisë ende mbesin pa përgjigje nga drejtësia ndërkombëtare; ndërkaq, Serbia vazhdon t’i mohojë krimet dhe t’i shpërblejë kriminelët.

Populli i Kosovës u ngrit pikërisht kundër këtyre krimeve dhe në mbrojtje të pragut të shtëpisë. UÇK-ja ishte ushtria e popullit të Kosovës; ishte betimi i përgjakur i njerëzve të shtypur që donin çlirimin e atdheut të tyre. Prandaj, sot e përgjithmonë, do ta mbrojmë drejtësinë e luftës sonë çlirimtare. Shteti i pavarur e sovran i Kosovës është amaneti ynë i përbashkët”, shkruan Osmani.

Ish-presidenti i Kosovës, Hashim Thaçi dhe Jakup Krasniqi u dënuan me 25 vite burgim. Rexhep Selimi është dënuar me 13 vjet burgim. Kadri Veseli u dënua me 18 vjet burgim.

Lini një Përgjigje

Koment *

Emër *

POSTOJE KOMENTIN

Ministri Gogu pas vendimit të Hagës: "Lufta e UÇK-së ishte luftë e drejtë, asnjë vendim gjykate nuk e ndryshon këtë"

13:40 Rajoni

"Lufta e UÇK-së ishte luftë për liri"/ Ali Ahmeti reagon pas vendimit në Hagë: Beteja vazhdon në apel

13:30 Rajoni

["Ditë e errët për drejtësinë ndërkombëtare, Parlamenti i Kosovës të heqë mbështetjen për tribunalet"/ Avokati i](#)
[Thaçit: Godita kokën me grushte kur...](#)

13:20 Rajoni / 2 komente

[Vengu kundër vendimit të Gjykatës Speciale: "Strehë e padrejtësisë", kërkon rrëzimin e dënimeve në apel](#)

13:12 Rajoni / 2 komente



Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.